



BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2012

LËNDA: BIOLOGJI (BËRTHAMË)

VARIANTI A

E shtunë, 30 qershor 2012

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20** pyetje.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët									
Kërkesa	10	11	12a	12b	13a	13b	13c	14a	14b
Pikët									
Kërkesa	15	16a	16b	16c	17	18	19a	19b	20
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Funkzioni i acideve nukleike është të: **1 pikë**
- A) çlirojë energji
 - B) sintetizojë enzima
 - C) tejçojë informacionin gjenetik
 - D) katalizojë reaksionet biokimike
2. Glikoliza është faza e përbashkët e: **1 pikë**
- A) frymëmarrjes qelizore dhe fermentimit
 - B) frymëmarrjes qelizore dhe fotosintezës
 - C) fotosintezës dhe fermentimit
 - D) fermentimit dhe fosforilimit
3. Trigliceridet formohen nga: **1 pikë**
- A) tre molekula aminoacidesh
 - B) tre molekula gliceroli
 - C) tre molekula acidesh lyrore
 - D) gliceroli dhe tre acide lyrore.
4. Cili nga komponimet e mëposhtme është një disakarid? **1 pikë**
- A) Glikogjeni
 - B) Celuloza
 - C) Glukoza
 - D) Sakaroza
5. Nga e ka burimin oksigjeni që çlirohet gjatë procesit të fotosintezës? **1 pikë**
- A) Dioksidi i karbonit
 - B) Glukoza
 - C) Ribulozodifosfati
 - D) Uji
6. Gjatë metafazës së mitozës: **1 pikë**
- A) fillon të shpërbëhet membrana bërthamore
 - B) kromozomet vendosen në planin ekuatorial të qelizës
 - C) kromozomet shkojnë drejt poleve të kundërta të qelizës
 - D) kromatidet shkojnë drejt poleve të kundërta të qelizës
7. Qelizat seksuale të mashkullit të njeriu përmbajnë kromozomet: **1 pikë**
- A) XX
 - B) vetëm X
 - C) X ose Y
 - D) vetëm Y

8. Njësia bazë strukturore dhe funksionale e mushkërive është: **1 pikë**
- A) bronku
 - B) bronkiola
 - C) hojëza
 - D) pleura
9. Hormoni i kundërrinimit (ADH) prodhohet nga: **1 pikë**
- A) folikulat
 - B) hipofiza
 - C) hipotalamusi
 - D) trupi i verdhë
10. Antikodoni është pjesë përbërëse e: **1 pikë**
- A) ADN
 - B) i-ARN
 - C) t-ARN
 - D) ATP
11. Tregoni 3 nga dallimet që ekzistojnë midis qelizave prokariote dhe qelizave eukariote. **3 pikë**
12. ATP luan një rol të rëndësishëm në proceset metabolike qelizore.
- a) Shpjegoni rolin e ATP si monedhë energjetike te gjallesat bimore dhe shtazore. **2 pikë**

b) Tregoni 2 nga dallimet midis frymëmarrjes qelizore dhe fotosintezës.

2 pikë

13. Ilustroni me nga një shembull artikulacionet e:

a) lëvizshme

1 pikë

b) gjysmë të lëvizshme

1 pikë

c) palëvizshme

1 pikë

14. Qarkullimi i gjakut dhe ekskretimi janë dy procese jetësore që kanë lidhje funksionale midis tyre.

a) Tregoni 2 nga dallimet midis arterieve dhe venave.

2 pikë

b) Në aparatin e ekskretimit formimi i urinës kryhet në nefron. Shpjegoni procesin e filtrimit dhe të ripërthithjes.

2 pikë

15. Tregoni si realizohet tretja e karbohidrateve në aparatin tretës të njeriu.

2pikë

16. Një pjesë e vogël e energjisë diellore është e mjaftueshme për të vënë në lëvizje zinxhirët ushqimorë.

a) Çfarë është prodhimtaria?

1 pikë

b) Për ç'arsye në çdo nivel trofik kemi zvogëlim progresiv të lëndës në dispozicion për nivelin pasues?

1 pikë

c) Çfarë shpreh ligji i të dhjetit?

1 pikë

17. Një burrë me grupin B të gjakut dhe flokë të drejtë dhe një grua me grupin AB dhe flokë të drejtë kanë dy fëmijë: njëri me grupin B dhe flokë të drejtë dhe një tjetër me grupin A dhe flokë kaçurrel. Çgjenotipe kanë prindërit e tyre duke ditur që këto janë dy tipare autosomike? Sa ka qënë mundësia teorike për secilin nga fëmijët që ata kanë?

3 pikë

18. Tregoni dy nga dallimet midis përzgjedhjes natyrore dhe përzgjedhjes artificiale.

2 pikë

19. Sistemi nervor dhe endokrin janë të lidhur ngushtësisht njeri me tjetrin.

a) Pse themi që funksionet e sistemit nervor dhe sistemit endokrin janë të bashkëlidhura?

1 pikë

b) Shpjegoni mekanizmin që realizon rregullimin e metabolizmit të kalciumit në organizëm.

2 pikë

20. Në një molekulë ADN-je sasia e Adeninës është sa dyfishi i Guaninës. Kjo molekulë ka 1200 nukleotide. Përcaktoni numrin e lidhjeve hidrogjenore në këtë molekulë ADN-je.

3 pikë